



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2022

“PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJ Nr.9867, datë 31.1.2008
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE
PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË LLOJEVE TË
RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9867, datë 31.1.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër” i ndryshuar bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit:

- a) fjalët: “revokim” dhe “revokon”, zëvendësohen me fjalët: “shfuqizim” dhe “shfuqizon”;
- b) fjalët “aplikim” dhe “aplikant” zëvendësohen me fjalët “kërkesë” dhe “kërkues”;
- c) fjalët: “Agjencinë/së e Mjedisit dhe të Pyjeve” zëvendësohen me fjalët: “Agjencinë/së Kombëtare të Mjedisit” ;
- ç) fjalët: “inspektor i Policisë Pyjore” zëvendësohen me fjalët: “inspektori përgjegjës për pyjet”;

Neni 2

Në nenin 17 pika 5 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

“5. Kur autoriteti menaxhues, në bashkëpunim me autoritetin shkencor, vëren mangësi në dokumentet e paraqitura, brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, i kërkon kërkuarit plotësimin e mangësive dhe pasaktësive të konstatuara brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast se kërkuari nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të kërkuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit bashkë me aktet e tjera”.

Neni 3

Neni 21 ndryshon si më poshtë:

“ Neni 21

Shfuqizimi

Ministria shfuqizon lejen kur:

- a) konstaton se është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin e një vendi të huaj, me konventën ose me rezolutat dhe vendimet e konferencës së palëve;
- b) provon se mbajtësi i lejes nuk ka përmbushur ndonjërin nga kushtet e përcaktuara në leje ose certifikatë”.

Neni 4

Neni 22 shfuqizohet

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA